

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje automjet zjarrfikës.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Automjete zjarrfikëse 34144210-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 333 333 (tre milion e treqind e tridhjetë e tri mijë e treqind tridhjetë e tre)lekë pa TVSH dhe 4 000 000 (katër milion) lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madhe, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

c. *Formularin e ofertës dhe listën e cmimeve të artikujve sipas shtojcave 1 dhe 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 - 2024 - 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët*

ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2023 - 2024 - 2025) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit. Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilanci të njepasnjeshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara (sipas shtojcës nr.9).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori Ekonomik pjesemarres duhet të paraqesë deklaratë garancie per mjetin per nje periudhe jo me pak se 1 vit dhe ne rast te defekteve, gjate kohes se riparimit te zevenedsoje mjetin me nje mjet alternativ te perafert me te.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me minimumi një vit garanci dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesemarres duhet te paraqese “Licence per Blerje dhe Shitje e mjeteve dhe pjeseve te nderrimit te tyre, Kodi VII.3.B”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mjetit të kërkuar janë hartuar duke u bazuar në fondin perates në dispozicion, nevojën e autoritetit kontraktor, terrenin ku do të operojë mjete objekt prokurimi.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Nr.	Pershkrimi	Limiti
1	Lloji i mjetit	Automjet zjarrefikes
2	Viti i prodhimit	Jo me heret se viti 2000
3	Ngjyra	-
4	Kilometrat e pershkruara	Jo me shume 80 000
5	Vellimi i motorrit (cm ³)	Jo me pak se 4500 cm ³
6	Numri i cilindrave	Jo me pak se 6
7	Fuqia motorrike (KW)	Jo me pak se 140 KW
8	Lenda djegese	Nafte
9	Konfigurimi i akseve	2 akse, aksi i pasem dopio gome
10	Transmisioni	Manual ose automatik
11	Sistemi i drejtimit	Ne krahun e majte
12	Kabina e mjetit	Dopio kabine me 4 dyer
13	Kapaciteti i ndenjeseve ne kabine	Jo me pak se 4+1 persona
14	Gjatesia	Minimumi 6000 mm

15	Nr.i gomave	-
16	Pesha/masa maksimale e autorizuar e mjetit	Jo me pak se 12 500 kg
17	Pesha e mjetit bosh	Jo me pak se 8 500 kg
18	Pompa	Pompe centrifugake per shtytje dhe thithje
19	Kapaciteti i perpunimit te pompes	Kapaciteti i perpunimit duhet te jete 1500 -3000 litra/min me presion 8-12 bar
20	Daljet e pompes	Duhet te jene te standarteve europiane STROZ ose ekuivalent me te
21	Kapaciteti mbajtes i ujit	Jo me pak se 2000 litra
22	Baraban minimumi 45 ml	1 cope me diameter 25/30 mm i lidhur direkt me pompen
23	Tubat	Tub gome min 50ml + hedhesen e ujit + top
24	Gjendja e mjetit	Mjeti duhet te jete ne gjandje te ire fizike si nga brenda ashtu edhe jashte

Keto specifikme jane hartuar nga sektori perkates, ai i MZSH dhe i pergjigjen nevojave qe k sektor ka per mjetin ne fjale.

Pesha, permasat dhe kapacitet bartese te personave dhe ujit jane ne perputhje me nevojat per mjet te tille per terren malor, per ta bere me te shpejte arritjen ne vatrata e zjarrit.

Viti i prodhimit dhe kilometrat jabe kerkuar duke patur parasysh edhe fondin ne dispozicion.